




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: N.T.SH “INFRATEK” me seli në Prishtinë, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën 03.11.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pabazë** Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e eliminuar, të subjektit në procedurë: N.T.SH “INFRATEK” me seli në Prishtinë, në procedurën e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve”, Nr.i prokurimit: VU644 – 20 – 713 – 2-1-1 e Nr. i brendshëm: 644-20-008-211.
2. **Vërtetohet si i bazuar** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 26.10.2020

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe ri-vlerësimit, krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës : O.E.: “**Arhiko Ing OP**” me seli në Prishtinë ndërsa, O.E.: N.T.SH “INFRATEK” me seli në Prishtinë (në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta radhit në mesin e O.E. të eliminuar, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. **26.10.2020**, bazuar në dispozitat e nenit 43 të Rregullores mbi Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi konsideron se A.K. duke vendosur si në Vendimin e dt. 26.10.2020 ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: Nenin 1, nenin 6, nenit 7, nenin 59, , nenin 60, Nenin 64 dhe 69 të LPP-së dhe vendimi i OSHP-së Nr. 395-404/20 të dt.28.07.2020.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë në tersin e saj, për arsye se:

*Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 60 paragrafi 1 pika 1.1 (**tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**) ka pasur për qëllim që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i ekzaminimi dhe vlerësimi të tenderëve të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 26.10.2020 është marrë bazuar*

në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së, vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.


Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A pika 10 paragrafi 10.1 të LPP-së A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 050/2020 - datë 04/11/2020**

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivët (1 kopje)

Drejtoria për Prokurim Publik


Amir Haradinaj, ZPP